

Njoftim

Sot, më datë **15.09.2023**, ora **08:30**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Sokol Ibi (Relator);**
- 2. Edlira Petri (Anëtare);**
- 3. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 4. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 5. Alma Kolgjoka (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr. "Ismail Qemali", Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.38 Regj.Themeltar, Datë 13.09.2023 Regjistrimi, me:

Paditës: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa.

I paditur: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve – KQZ, përfaqësuar nga z. Erion Meta dhe z. Erdal Mema.

Person i interesuar: Partia e Lirisë, në mungesë.

Objekti: Shfuqizimi i vendimit nr. 181, datë 07.09.2023, të KAS "Për rishqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 93, datë 20.08.2023, të depozituar nga Partia Politike "Partia Demokratike e Shqipërisë".

Ndryshimi i vendimit të Komisionerit nr. 722, datë 19.08.2023, duke e ndryshuar në shkronjën "b" dhe "c" të pikës 1 të tij, si më poshtë:
b) dy anëtarë propozohen nga "Partia Demokratike" (PDSH)
c) një anëtar propozohet nga "Partia e Lirisë".

Baza ligjore: Nenet 21, 64, 65 dhe 66, 124, 124/1, 145 e në vazhdim të Kodit Zgjedhor; Nenet 1 dhe 2 të Udhëzimit nr. 01, datë 23.12.2020 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit".

me Vendimin Nr. 35, datë 15.09.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, unanimisht,

VENDOSI:

1. Pranimin e padisë.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 181, datë 07.09.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.
3. Ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 722, datë 19.08.2023, në shkronjën “b” dhe “c” të pikës 1 të tij, si më poshtë:
 - b) dy anëtarë propozohen nga “Partia Demokratike e Shqipërisë” (PDSH);
 - c) një anëtar propozohet nga “Partia e Lirisë” (PL).
4. Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palës së paditur.
5. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.
 - U shpall në Tiranë më datë 15.09.2023.

Tiranë, më 15.09.2023

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë